

ABSTRAKT

“Mirëqenia e fëmijëve dhe puna e fëmijëve-përcaktuesit dhe efektet e saj”

Punimi përmban analizë të temës “Mirëqenia e fëmijëve dhe puna e fëmijëve-përcaktuesit dhe efektet e saj”.

Dispozitat ligjore nacionale në njërin anë dhe ato ndërkombëtare në anën tjetër, po ashtu konventat e ndryshme në mënyrë të vazhdueshme bëjnë përpjekje që të mbrohen të drejtat e fëmijëve, të mos rrezikohet mirëqenia e tyre, si dhe të trajtohen në mënyrë të duhur.

Që të arrijmë në shpjegimin e të gjithë këtyre dukurive do të përqendrohemi në raportin thelbësor të së drejtës zakonore shqiptare me ligjin, si dhe lidhjen e saj me organizimin e shoqërisë, duke vazhduar tutje me përpjekjen e institucioneve shtetërore përmes mekanizmave të ndryshëm në përndjekjen e rasteve ku në një formë apo tjetër cenohen të drejtat themelore të fëmijëve, deri tek mekanizmat dhe alternativat adekuate që shërbejnë për eliminimin dhe parandalimin e veprimeve jo të ligjshme ndaj fëmijëve.

Qëllimi primar i synimit të këtij punimi është analizimi i detajuar sa i përket të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre, trajtimit të tyre fillimisht nga ana e familjes pastaj edhe nga ana e organeve shtetërore. Mirërritja e fëmijëve dhe trajtimi i tyre në mënyrë të dinjitetshme është bazë e një shoqërie demokratike

Fjalë kyçe: *Mirëqenia e fëmijëve, mbrojtja e të drejtave, abuzimet, keqtrajtimet, fëmijët në nevojë, fëmijët pa përkujdesje, asistencë sociale, të drejtat e njeriut, barazia, legjislacioni shtetëror etj.*

Kandidatja : Xheneta Ibrahim

Mentori : Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri